



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:174822

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05704805

KPPP.nr. 1407/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me numër unik identifikues 811288001 dhe me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër të unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 131/2021 i datës 31.03.2021, të lejuar nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi nga Prishtina, në seancën dëgjimore të datës 25.05.2024 morri merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore në mes të kreditorit Telekom i Kosovës SH.A., kundër debitorit Trepça SH.A., në lëndën sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.131/21 të datës 31.03.2021, të lëshuar nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, për shkak të tërheqjes së propozimit nga kreditori.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me datë 31.03.2021 ka lëshuar urdhrin P.nr. 131/2021, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 141001049846/1938, e datës 30.06.2019; Faturës nr. 141001049846/1944, e datës 31.07.2019; Faturës nr. 141001049846/1951, e datës 31.08.2019; Faturës nr. 141001049846/1957, e datës 30.09.2019; Faturës nr. 141001049846/1962, e datës 31.10.2019; Faturës nr. 141001049846/1974, e datës 30.11.2019; Faturës nr. 141001049846/1981, e datës 31.12.2019; Faturës nr. 141001049846/1986, e datës 31.01.2020; Faturës nr. 141001049846/1996, e datës 29.02.2020; Faturës nr. 141001049846/2002; e datës 31.03.2020; Faturës nr. 141001049846/2008, e datës 30.04.2020; Faturës nr.

141001049846/2014, e datës 31.05.2020; Faturës nr. 141001049846/2020, e datës 30.06.2020; Faturës nr. 141001049846/2026, e datës 31.07.2020; Faturës nr. 141001049846/2034, e datës 31.08.2020; Faturës nr. 141001049846/2038, e datës 30.09.2020; Faturës nr. 141001049846/2051, e datës 31.10.2020; Faturës nr. 141001049846/2057, e datës 30.11.2020; Faturës nr. 141001049846/2063, e datës 31.12.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 5,679.90 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar *prapësim* duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv apo tipare të përbarueshmërisë. Ka shtuar se e konteston shumën e përgjithshme të borxhit sepse borxhi prej 5,679.90 € nuk është real për faktin se faturat e bashkangjitura në propozimin për përbarim nuk përputhen me faturat të cilat gjenden në Departamentin e Financave, e ku vlera aktuale është 4,336.05 €. I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin për përbarim P.nr. 131/2021, të datës 31.03.2021.

Me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimit të debitorit, gjykata, ka caktuar seancë dëgjimore me datë 25.05.2024.

Në seancën dëgjimore, i autorizuari i kreditorit e ka njoftuar gjykatën se në këtë lëndë përbarimore, kreditori ka tërhequr propozimin për përbarim pranë Përbaruesit Privat, kjo për shkak të përmbushjes së borxhit nga debitori. Andaj ka kërkuar nga gjykata që procedura në fjalë të përfundohet.

Në seancë nuk ka prezantuar debitori i ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata vlerësoi parashtrësën e kreditorit të datës 01.02.2024 drejtuar Përbaruesit Privat me të cilin është tërhequr propozimi për përbarim, dhe gjeti se e njëjta gjen mbështetje në nenin 41 par. 1 të LPP-së me të cilin përcaktohet se “*Propozimi për përbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përbarimore pa pëlqimin e debitorit*”.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet për përfundimin në tërësi të procedurës në këtë çështje juridike përbarimore kjo në kuptim të nenit 42.2 i cili përcakton se “*Në rast të*

*tërheqjes së propozimit për përmbarim organi përmbarues e përfundon përmbarimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht”.*

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42, par.1 dhe par.2 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1407/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.